

Divizioni i Skemave Pensionale
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kërkohet këshillë nga AIP se si të trajtohet kërkesa për QDP në të gjitha dokumentet që lidhen me procesin e vlerësimit nga komisioni përkatës, i cili, në vlerësimin e fundit, në mungesë të pranisë së palës (subjekt i të dhënave personale), i ka hequr të drejtën e përfitimit mujor nga skema e kompensimit për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

AIP / ShQDP

Shikuar nga këndvështrimi i Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP), pala kërkuuese, e cila, sipas përkufizimeve të këtij ligji, konsiderohet subjekt i të dhënave personale. Ajo nga MPMS ka kërkuar qasje në të gjitha dokumentet që lidhen me procesin e vlerësimit nga komisioni përkatës, i cili, në vlerësimin e fundit, në mungesë të pranisë së saj, i ka hequr të drejtën e përfitimit mujor nga skema e kompensimit për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Çështja e objektivitetit të vlerësimit nga ana e komisionit nuk është në kompetencë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Megjithkëtë, e drejta e saj për të pasur qasje në dokumentet publike, përmbajtja e të cilave ngërthen në vete të dhëna personale të vet subjektit të të dhënave (në këtë rast, të palës kërkuuese), nuk mund të mohohet nga institucioni publik (MPMS), sepse këtë e garanton neni 14 i Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Veç kësaj, pala, këtë të drejtë për t'u qasur në dokumentet publike, sipas kërkesës së saj të datës, e ka të garantuar edhe sipas nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-81 për Qasje në Dokumente Publike, me ç'rast refuzimi eventual i cilitdo dokument publik të kërkuar që është prodhuar nga institucioni publik (MPMS) gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit të gjendjes (psiko) fizike, nëse vazhdon ti plotësojë kriteret për t'u cilësuar si person paraplegjik apo/edhe tetraplegjik, nuk e plotëson asnjërin nga kriteret e cilitdo nënparagraf të paragrafit 2 të nenit 17 të këtij ligji. Për më tepër, përbërja e komisionit vlerësues duhet të jetë transparente, gjersa anëtarët e të njëjtit kanë kompetencë për të bërë rekomandim (pozitiv apo negativ) të niveli vendimarrës, nga i cili vendim, pastaj pala mund të përfitojë apo të humbë një përfitim eventual, të cilin edhe mund ta ketë gëzuar në të kaluarën. Subjekti i të dhënave (sipas LMDHP) ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë të njoftohet se kush (në kuptim të të punësuarve brenda institucionit publik apo kontrolluesit të të dhënave) ka qasje në të dhënat e saj.

Andaj, ju këshilloj që ZKA i institucionit tuaj (i cili, sipas LQDP është zyrtar përgjegjës, me përgjegjësi vendimarrjeje gjatë shqyrtimit të një kërkesë për QDP) të marrë vendim aprovues ndaj palës kërkuuese, duke i ofruar palës qasje të plotë ndaj dokumenteve të kërkuara!